



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 17 Mars 2021

Nr: 158

VENDIM

**PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA PËR
NDRYSHIM PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72, pikat 1 e 2, dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, dhe të shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, pasi shqyrtova kërkesën e depozituar nga Partia Lëvizja për Ndryshim, për miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, dhe relacionin e paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92, shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

Me vendimin nr. 27, datë 15.02.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Partia Lëvizja për Ndryshim është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Në bazë të neneve 67 dhe 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Partia Lëvizja për Ndryshim, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore më datë 8.3.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 125 datë 10.03.2021, vendosi kthimin për korrigjimin e dokumentacionit, të listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet të subjektit zgjedhor, Partia Lëvizja për Ndryshim.



Brenda afatit ligjor subjekti zgjedhor Partia Lëvizja për Ndryshim ridepozitoi dokumentacionin e korrigjuar.

Dokumentacioni i paraqitur përmban:

1. Listat shumemërore për 12 Zonat Zgjedhore; Model - 03
2. Deklaratat e kandidatëve të listave shumemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën e votës dhe se pranojnë të kandidojnë si kandidat të listës shumemërore të Partisë Lëvizja për Ndryshim; Model – 05;
3. Kopje të dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët e listave shumemërore;
4. Jetëshkrimin për të gjithë kandidatët e listës shumemërore Model – 07;
5. Vërtetimin nga Kuvendi i Shqipërisë, i cili vërteton se Partia Lëvizja për Ndryshim, ka deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
6. Formularët e vetëdeklarimit për të gjithë kandidatët, në zbatim të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Në mbështetje të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për deputet të Partisë Lëvizja për Ndryshim dhe dokumentacionin përkatës ligjor të paraqitur dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara nga nenet 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor.

Në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit, nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, kandidatët për deputet, të subjektit politik Partia Lëvizja për Ndryshim, kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, të kandidatëve për deputetë, rezulton se përveç kandidateve të poshtëpërmendur, të gjithë kandidatët e tjerë nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar.

1. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **zj. Arjeta Barjam Cumani**, kandidat për deputet, qarku Fier, me numër rendor 2, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pikës 1, “*A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Me vendimin nr. 303 datë 15.05.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e ka dënuar për veprën penale, parashikuar nga neni 309, për të cilën është vendosur masë dënimi me gjobë. Është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit. Është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë.

Pikës 2, “*A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Me vendimin nr. 1381 datë 28.05.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka deklaruar fajtor për kundërvajtjen me gjobë, parashikuar nga neni 320/1, vendim i cili është ankimuar në Gjykatën e Apelit.

2. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Agron Sadik Demushi**, kandidat për deputet, qarku Kukës, me numër rendor 2, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit:

Pikës 1, “*A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Me vendimin nr. 17 datë 05.02.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, e ka dënuar për veprën penale kundërvajtje, parashikuar nga neni 257/A/1, për të cilën është vendosur masa e dënimit me gjobë .

Pikës 8, *A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po”, duke deklaruar se:

Ka jetuar në Bronx, NY, USA, për periudhën korrik 2015 e në vijim.

3. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Dashamir Mehmet Tahiri**, kandidat për deputet, qarku Vlorë me numër rendor 1, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pikës 1, “*A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:



Gjykata e Ravenës Itali, me vendimin e datës 28.10.2009 është dënuar me 9 (nëntë) muaj për veprën penale “Ngarja e automjetit me leje drejtimi të falsifikuar”, parashikuar nga neni 648 i Kodit Penal Italian.

Pikës 3, “A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organte ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Ka qënë në hetim nga Gjykata e Ravenës, Itali, për veprën penale “Drejtim automjeti me leje të falsifikuar, më datë 28.10.2009, rezultatit i së cilës është “Marrë pafajësi nga Gjykata e Bolonjës, Itali, më datë 19.11.2019.

4. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Gjon Gjet Ndoj**, kandidat për deputet, qarku Lezhë me numër rendor 3, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pikës 1, “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Me vendimin nr. 592 datë 22.12.2016, Gjykata e Apelit Shkodër e ka dënuar për veprën penale parashikuar nga neni 257/a/1 “Mosdeklarim Pasurie”, për të cilën është vendosur masa e dënimit me gjobë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit, nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, paragrafi 2, shkronja “b” dhe paragrafi 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresat nr. 1778 prot., datë 08.03.2021, **nr. 2083 prot., datë 16.03.2021 dhe nr. 2174 prot., datë 17.03.2021 (shkresa të dërguara për shkak të ndryshimit të gjenealiteteve të kandidatëve)** ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresat nr. 1777 prot., datë 08.03.2021, **nr. 2082 prot., datë 16.03.2021 dhe nr. 2172 prot., datë 17.03.2021 (shkresa të dërguara për shkak të ndryshimit të gjenealiteteve të kandidatëve)** ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatët për deputet në Kuvendin e Shqipërisë, të subjektit politik Partia Lëvizja për Ndryshim, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresat nr. 2515/1 prot., datë 09.03.2021 dhe 2726/1 prot., datë 16.03.2021 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e gjendjes gjyqësore



për kandidatët e për deputet, të subjektit politik Partia Lëvizja për Ndryshim, sipas të cilës rezultoi si vijon:

1. **Qarku Fier, zj. Arjeta Barjam Cumani, me numër rendor 2**, në bazë të vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 17 prot., datë 09.03.2021, me vendimin nr. 303 datë 15.05.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e deklaroi fajtor për veprën penale të “Ekspertimit të Rremë”, e në bazë të nenit 309 Kodi Penal dhe nenit 406 K.Pr.P e dënonte me 400.000 (katërqind mijë) lekë gjobë.

Gjykata e Apelit me vendimin nr. 611 datë 22.11.2018 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit. Rehabilituar në bazë të nenit 69 Kodi Penal.

Referuar deklaratimeve të kandidatit për deputet **zj. Arjeta Barjam Cumani** si dhe përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve vërehet se dënimi me 400.000 (katërqind mijë) lekë gjobë sipas parashikimeve të nenit 309 të Kodit Penal, nuk përfshihet në sferën e ndalimeve të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Referuar të dhënave të disponuara të kandidatit nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/moszgjedhshmërisë.

2. **Qarku Kukës, z. Agron Sadik Demushi, me numër rendor 2**, në bazë të vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 17 prot., datë 09.03.2021, me vendimin nr. 17 datë 05.02.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, e ka deklaruar fajtor për veprën penale “Refuzim për deklaram, mos deklaram, fshehje ose deklaram i rremë i pasurisë së personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrim ligjor për deklaram” parashikuar nga neni 257/A/1 Kodi Penal dhe neni 406 K.Pr.P, duke u dënuar me 100.000 (njëqind mijë) lekë gjobë.

Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 233 datë 01.06.2016 ka vendosur mospranimin e ankimit.

Rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

Referuar deklaratimeve të kandidatit për deputet **z. Agron Sadik Demushi** si dhe përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve vërehet se dënimi sipas parashikimeve të nenit 257/A/1 të Kodit Penal, nuk përfshihet në sferën e ndalimeve të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Referuar të dhënave të disponuara të kandidatit nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/moszgjedhshmërisë.

Kandidatët e tjerë të listës shumëmemërore, të subjektit politik Partia Lëvizja për Ndryshim, rezultojnë të jenë të padënuar.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatët për deputet, të subjektit politik Partia Lëvizja Për Ndryshim.



Referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, të dhënat e deklaruar në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për kandidatët për deputet, të subjektit politik Partia Lëvizja për Ndryshim nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatëve, për Zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021.

Pas verifikimeve përkatëse të kërkesës dhe dokumentacionit në tërësi të listave shumemërore të Partisë Lëvizja Për Ndryshim, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, konstatoj se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 67, 72 dhe 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72, pikat 1 e 2 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, dhe në shkronjën “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar,

V E N D O S :

1. Miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për deputetë, të Partisë Lëvizja për Ndryshim, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për zonat zgjedhore, Qarku Berat, Qarku Dibër, Qarku Durrës, Qarku Elbasan, Qarku Fier, Qarku Gjirokastrë, Qarku Korçë, Qarku Kukës, Qarku Lezhë, Qarku Shkodër, Qarku Tiranë dhe Qarku Vlorë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





Lista shumemërore

Partia Lëvizja Për Ndryshim

Qarku Berat

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Miranda	Abdyl	Haxhia	17/04/1963	F
2	Edmond	Miltiadh	Sinjari	23/10/1976	M
3	Alion	Astrit	Kaloçi	10/06/1996	M
4	Mikeliano	Syri	Harka	21/07/1995	M
5	Enea	Fatos	Saliasi	31/05/1994	F
6	Ogerta	Faik	Paci	18/11/1997	F
7	Kristi	Hajri	Skenderaj	01/09/1999	M
8	Xheni	Valdet	Hoxha	15/07/2002	F
9	Retilda	Gentian	Musa	19/11/2002	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 9

Partia Lëvizja Për Ndryshim

Qarku Dibër

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Sandra	Shefqet	Xheleshi	26/04/1995	F
2	Neda	Nezir	Stana	21/01/1997	F
3	Besar	Abdi	Murati	24/03/2000	M
4	Flavio	Gezim	Pjetri	25/09/1997	M
5	Aldona	Afrim	Koka	26/03/1998	F
6	Dhurata	Ahmet	Kola	27/08/1980	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 6



Lista shumemërore

Partia Lëvizja Për Ndryshim

Qarku Durrës

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Jozefina	Filip	Topalli	26/11/1963	F
2	Lorenc	Vangjel	Aleksi	28/06/1980	M
3	Dritan	Petrit	Hila	20/05/1981	M
4	Keti	Qendro	Curani(Koçi)	09/03/1964	F
5	Elton	Sadik	Sufa	04/08/1989	M
6	Megi	Astrit	Tirana	08/11/1986	F
7	Stefan	Zef	Pogu	19/01/1986	M
8	Demiana	Dritan	Broli	27/05/1997	F
9	Francesca	Shkelzen	Memia	19/08/2000	F
10	Robena	Robert	Çitozi	15/04/2002	F
11	Marisa	Kozma	Ndreko	14/07/1996	F
12	Bardhyl	Adnand	Mehmeti	30/03/2001	M
13	Mario	Edmond	Lelo	26/03/1991	M
14	Malvina	Sali	Lleshi	08/01/1998	F
15	Aldis	Ali	Aliaj	16/07/1986	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 15

Partia Lëvizja Për Ndryshim

Qarku Elbasan

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Evald	Filip	Serreqi	15/03/1985	M
2	Erion	Haki	Curra	18/11/1983	M
3	Valentina	Durim	Halili	31/07/1998	F
4	Klevis	Agron	Soça	31/03/1991	M
5	Armand	Lefter	Hoxhallari	29/01/1994	M
6	Besiana	Ylli	Biçaku	13/12/1999	F
7	Dashuri	Shaqo	Aliaj	08/04/1985	F
8	Enis	Viktor	Toçi	28/12/1997	M
9	Safije	Adriatik	Tabaku	27/04/2001	F
10	Bardhul	Hyqmet	Pisha	28/04/2000	M
11	Edije	Kalem	Malja	01/09/1998	F
12	Klevis	Ferdinand	Pali	26/10/1999	M
13	Manuel	Livan	Sefa	25/04/1999	M
14	Arsen	Zenel	Bardhi	09/06/1984	M
15	Anila	Fatmir	Gega	03/04/1990	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 15



Lista shumemërore

Partia Lëvizja Për Ndryshim

Qarku Fier

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Najada	Skender	Halilosmani(Selmani)	27/03/1982	F
2	Arjeta	Barjam	Çumani	18/01/1958	F
3	Fatjon	Bashkim	Çela	11/12/1981	M
4	Mikel	Spiro	Visha	30/05/1991	M
5	Kejdi	Bledar	Alushaj	11/05/2001	M
6	Shpresa	Xhemil	Muçaj	17/04/1986	F
7	Ilda	Idajet	Buça	28/09/1998	F
8	Migena	Isuf	Bala	05/05/1995	F
9	Galip	Muharrem	Arapi	09/05/2002	M
10	Qamile	Ylli	Resulaj	20/08/1987	F
11	Erind	Muharrem	Rama	07/09/1994	M
12	Tonin	Leke	Trupi	16/08/1954	M
13	Griselda	Imer	Xhika	04/01/1987	F
14	Erjon	Hodo	Hamzaj	30/05/1988	M
15	Sergei	Dashmir	Ndreu	10/09/2000	M
16	Ergi	Klaus	Cani	13/12/2001	M
17	Eliona	Mehdi	Çaushti	05/05/1984	F
18	Marsel	Gjergj	Nelko	26/03/1989	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 18

Partia Lëvizja Për Ndryshim

Qarku Gjirokastrë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Adile	Muho	Gjoka	12/05/1998	F
2	Rikeldo	Dashamir	Ndreu	12/12/1995	M
3	Lorena	Xhevair	Kapllani	19/06/1986	F
4	Renaldo	Xhevdet	Rama	20/07/1997	M
5	Mexhite	Gjikë	Tahiri	18/03/2002	F
6	Dorjan	Isuf	Likollari	01/02/1984	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 6



Lista shumemërore

Partia Lëvizja Për Ndryshim

Qarku Korçë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Aleksandër	Pandi	Petre	14/07/1976	M
2	Irena	Veli	Jano	09/03/1970	F
3	Eglant	Ferzi	Tollaku	25/02/1987	M
4	Aleksander	Aleks	Kyçyku	05/04/1994	M
5	Klevis	Parim	Maze	03/12/1992	M
6	Vilma	Viktor	Zeqir	08/12/1997	F
7	Irisa	Shpëtim	Karaj	17/01/1992	F
8	Sheila	Arben	Hazna	04/01/2003	F
9	Albert	Hamit	Mojsja	01/08/1990	M
10	Flavia	Kol	Pema	16/01/1995	F
11	Xhenis	Llukan	Jano	11/01/1998	F
12	Klaudia	Rexhep	Muço	09/01/1997	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 12

Partia Lëvizja Për Ndryshim

Qarku Kukës

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Elsa	Ruzhdi	Domi	02/09/1974	F
2	Agron	Sadik	Demushi	25/09/1973	M
3	Orlind	Besnik	Morina	11/01/1988	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 3

Partia Lëvizja Për Ndryshim

Qarku Lezhë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Jozefina	Filip	Topalli	26/11/1963	F
2	Matilda	Fran	Gjini	22/08/1994	F
3	Gjon	Gjete	Ndoj	25/05/1967	M
4	Dod	Frok	Prenga	07/02/1969	M
5	Florian	Gjok	Pllumbi	29/12/1988	M
6	Alda	Zef	Gjini	13/05/1995	F
7	Tonin	Mark	Valca	08/04/1967	M
8	Amarda	Ndre	Gjini	20/05/1998	F
9	Arben	Vuksan	Vuksani	06/12/1967	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 9



Lista shumemërore

Partia Lëvizja Për Ndryshim

Qarku Shkodër

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Jozefina	Filip	Topalli	26/11/1963	F
2	Adela	Muhamet	Kryeziu	29/05/1990	F
3	Visar	Nadir	Erkoçi	06/05/1977	M
4	Melisa	Ndoc	Braci	08/08/1998	M
5	Nora	Ndoj	Deda	17/04/1969	F
6	Gjovalin	Nik	Kastrati	28/07/1964	M
7	Alfred	Ndoc	Alia	08/03/1987	M
8	Orjon	Nail	Rroji	28/09/1978	M
9	Teuta	Mustaf	Hoti	28/04/1967	F
10	Nest	Dede	Zefi	19/02/1978	M
11	Jurgen	Sokol	Drrasati	11/03/1995	M
12	Elsa	Agron	Sherri	07/07/1997	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor

12



Lista shumemërore

Partia Lëvizja Për Ndryshim

Qarku Tiranë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Jozefina	Filip	Topalli	26/11/1963	F
2	Robert	Xheladin	Çitozi	14/04/1966	M
3	Polikron	Niko	Pulluqi	27/02/1961	M
4	Elida	Kole	Hoxha	08/01/1961	F
5	Lorenc	Shtjefën	Radovani	14/04/1960	M
6	Desilda	Luan	Jonuzaj	28/10/1992	F
7	Leke	Valentin	Negri	10/06/1977	M
8	Meri	Kristaq	Lalaj	27/06/1940	F
9	Arben	Sami	Basha	31/08/1964	M
10	Genadi	Albert	Mero	13/10/1987	M
11	Stela	Françesko	Jakova	28/03/1985	F
12	Joniz	Bujar	Osmanagaj	09/03/1984	M
13	Fleino	Enos	Mozali	31/05/1989	M
14	Doris	Marlind	Myftiu	31/01/2003	M
15	Daniela	Pjetër	Kavaja	27/03/1984	F
16	Sokol	Agim	Mezini	11/07/1965	M
17	Edisnajd	Gani	Xhafa	21/11/1993	M
18	Ravena	Spiro	Aleksi	29/09/1976	F
19	Drita	Edmond	Ymeri	01/08/1997	F
20	Adlei	Arjan	Lleshi	13/12/2000	M
21	Kim	Ilir	Kurti	21/11/1996	M
22	Lorenc	Lavdërim	Spata	16/06/1994	M
23	Lorna	Lulzim	Lelçaj	24/02/2002	F
24	Emanuel	Ndue	Bisha	05/11/2000	M
25	Klevi	Arif	Karafili	19/07/2001	M
26	Odeta	Gjergji	Marini	17/12/1984	F
27	Jurgen	Kujtim	Hoxha	24/10/1992	M
28	Santjola	Ilirjan	Hasanaj	28/10/2000	F
29	Renato	Haki	Gërdeci	10/11/1989	M
30	Rei	Artjan	Tenolli	23/03/1992	M
31	Selim	Kasem	Balla	08/07/1987	M
32	Alges	Albert	Sanxhaku	13/08/1996	M
33	Berjola	Qerim	Mema	23/10/1990	F
34	Gentian	Bardh	Ndoj	12/08/2000	M
35	Renaldo	Agim	Lalaj	15/07/1992	M
36	Armela	Gani	Abakay	08/12/1996	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor

36



Lista shumemërore

Partia Lëvizja Për Ndryshim

Qarku Vlorë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Dashamir	Mehmet	Tahiri	16/09/1966	M
2	Edion	Shpëtim	Muho	03/12/1989	M
3	Bukuroshe	Sherif	Isufaj	02/03/1968	F
4	Besmir	Agim	Taka	05/05/1987	M
5	Krenar	Bardho	Gjonzeneli	06/03/1977	M
6	Anife	Hizer	Brahimi	30/11/1990	F
7	Adrian	Vullnet	Gjoka	15/09/1968	M
8	Arjana	Teki	Hilgega(Demi)	06/12/1960	F
9	Gerti	Artur	Meçaj	11/08/2001	M
10	Xhorxhi	Niqifor	Foto	18/07/1968	M
11	Neida	Neim	Idrizaj	27/09/1995	F
12	Genci	Ruzhdi	Sulejmani	25/02/1984	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 12Subjekti Zgjedhor ka: 153 candidate